



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 maj 2020
Nr. Ref.:RK1571/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI127/19

Parashtrues

Benizar Berisha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr.
4988/18, të 13 marsit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Benizar Berisha (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), e cila përfaqësohet nga avokatet Arianit Koci dhe Nora Veliu.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [Ac.nr. 4988/18] të Gjykatës së Apelit, të 13 marsit 2019 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i kontestuar), të cilin e ka pranuar, më 3 prill 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të saj të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor), të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 2 gusht 2019, kërkesa është dorëzuar në postë dhe më 14 gusht 2019 është regjistruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 20 gusht 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi (anëtarë).
7. Më 2 shtator 2019, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të saj ia dërgoi Gjykatës së Apelit, në pajtim me ligjin.
8. Më 13 maj 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Lidhur me rastin pranë nesh, janë zhvilluar dy sete të procedurave

Procedura kontestimore

9. Më 16 qershor 2015, parashtruesja ka parashtruar kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke kërkuar: (i) besimin, kujdesin dhe edukimin e

fëmijës O.M, dhe (ii) akordimin e alimentacionit, me propozimin që shuma mujore e pagesës, në emër të alimentacionit të jetë 300€ (treqind euro), deri në ekzistimin e kushteve ligjore.

10. Më 2 tetor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin [C.nr. 1395/15], e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës dhe vendosi: (i) që fëmijën O.M t'ia besojë në kujdesje dhe edukim parashtrueses së kërkesës (së ëmës), dhe (ii) detyroi të paditurin (ish-bashkëshortin), që në emër të alimentacionit t'ia paguaj parashtrueses së kërkesës shumën mujore në lartësinë prej 200€ (dyqind euro), duke filluar nga dita e parashtrimit të kërkesëpadisë më 16 qershor 2015, e deri në ekzistimin e kushteve ligjore. Kundër këtij Aktgjykimi, ish-bashkëshorti i parashtrueses së kërkesës, brenda afatit ligjor, parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, nëpërmjet së cilës kontestoi lartësinë e pagesës mujore të alimentacionit.
11. Më 11 qershor 2018, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin [AC. nr.1302/2018], ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, [C.nr.1395/15] të 2 tetorit 2017, duke e ulur lartësinë e pagesën mujore të alimentacionit, nga 200 € (dyqind euro), në 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro) duke filluar nga dita e parashtrimit të kërkesëpadisë më 16.06.2015 e tutje derisa të ekzistojnë kushtet ligjore.

Procedura përmbaremore

12. Më 1 gusht 2018, duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [Ac.Nr.1302/2018] të 11 qershorit 2018, parashtruesja e kërkesës në Gjykatën Themelore në Prizren, parashtrroi kërkesë për ekzekutimin e shumës së mbledhur të alimentacionit në lartësinë prej 5500 € (pesëmijë e pesëqind euro) (objekti i përmbaremit).
13. Më 28 korrik 2018, Gjykata Themelore në Prizren, dega në Suharekë, me Aktvendimin [Cp.nr.82/2018], aprovoi kërkesën e parashtrueses së kërkesës për përmbaremin e shumës së përgjithshme në lartësinë prej 5500 € (pesëmijë e pesëqind euro).
14. Më 6 shtator 2018, ish-bashkëshorti i parashtrueses së kërkesës ushtroi prapsim në Gjykatën Themelore në Prizren, dega në Suharekë, kundër Aktvendimit [Cp.nr.82/2018] të 28 korrikut 2018, me pretendimin se një pjesë e detyrimit nga shuma e përgjithshme e alimentacionit ishte paguar nga i njëjti përgjatë viteve 2015-2017.
15. Më 21 shtator 2018, parashtruesja e kërkesës parashtrroi përgjigje në prapësimin, nëpërmjet të cilës kërkoi refuzimin e prapësimin të ushtruar nga ish-bashkëshorti dhe lënien në fuqi të Aktvendimit [Cp.nr.82/2018] të Gjykatës Themelore në Prizren, dega në Suharekë, të 28 korriku 2018.
16. Më 1 tetor 2018, Gjykata Themelore në Prizren, dega në Suharekë, me Aktvendim [Cp.nr.82/2018], aprovoi pjesërisht si të bazuar, prapësimin e ish-bashkëshortit të parashtrueses së kërkesës dhe vendosi shumën e detyrimit të përgjithshëm në lartësinë prej 4700 € (katërmijë e shtatëqind euro).

17. Më 17 tetor 2018, Gjykata Themelore në Prizren, dega në Suharekë, mori vendim për korigjimin e Aktvendimit të saj [Cp.nr.82/2018], të 1 tetorit 2018, duke e ndryshuar lartësinë e borxhit nga 4700 € (katërmijë e shtatëqind euro) në gjithsejtë 2800 € (dymijë e tetëqind euro), me arsyetimin se një pjesë të detyrimit në lartësinë prej 2750 € (dymijë e shtatëqind e pesëdhjetë euro), e kishte përmbushur ish-bashkëshorti i parashtrueses së kërkesës, përgjatë viteve 2015-2017.
18. Më 18 tetor 2018, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Prizren, dega në Suharekë, të 1 dhe 17 tetorit 2018, për shkak të shkeljeve të pretenduara të dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbartimore (LPP).
19. Më 13 mars 2019, Gjykata e Apelit me Aktvendimin, [Ac.nr.4988/18], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimet e Gjykatës Themelore në Prizren, dega në Suharekë, të 1 dhe 17 tetorit 2018, si të drejta, me arsyetimin se: *“Zbatimi i ligjit material në këtë çështje kontestueses, përveç se është zbatuar drejtë sa i përket detyrimit të debitorit për inkasimin e mjeteve të alimentacionit, në raport me kreditoren i njëjti është zbatuar drejtë edhe sa i përket lartësisë.”*
20. Më 7 maj 2019, parashtruesja e kërkesës, kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [Ac.nr.4988/18], të 13 marsit 2019, ushtroi propozim në prokurorinë e shtetit për ushtrimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljeve thelbësore të ligjit procedural.
21. Më 15 maj 2019, Zyra e prokurorit të shtetit, me njoftimin KMLC.nr.83/2019 informon parashtruesen e kërkesës se propozimi i saj për ushtrimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është aprovuar me arsyetimin: *“sepse pretendimet e cekura në propozimin tuaj nuk janë të mjaftueshme për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë sipas nenit 247.1 pika a) dhe b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore.”*

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

22. Parashtruesja e kërkesës pretendon se përmes Aktvendimit të kontestuar i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor), të KEDNJ.
23. Parashtruesja e kërkesës specifikisht pretendon se:

“...Gjykata e Apelit në cilësinë e gjykatës përmbartimore të shkallës së dytë, e ka shkelur parimin Res Judicata dhe parimin e sigurisë juridike, ngase ka rihapur çështjen e vendosur me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.Nr.1302/2018 i datës 11.06.2018, i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm - i referuar në këtë ankesë si Vendim i gjykatës kontestimore të shkallës së dytë apo Vendim Res Judicata. Rrjedhimisht, me këtë është cenuar e Drejta e parashtrueses së kërkesës në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, e garantuar me Nenin 31 të Kushtetutës lidhur me Nenin 6 të KEDNJ-së.”

24. Parashtruesja e kërkesës më tej thekson se:

“...gjykata përmbarimore e shkallës së parë dhe gjykata përmbarimore e shkallës së dytë kanë shkelur të drejtën e saj kushtetuese të garantuar me Nenin 31 të Kushtetutës, kur janë lëshuar në shqyrtimin e lartësisë së borxhit të vendosur me Aktgjykim të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1395/2015 i datës 02.10.2017, i ndryshuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.Nr.1302/2018 i datës 11.06.2018, i bërë i plotfuqishëm, i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm (Vendim Res Judicata).

*Gjykata përmbarimore e shkallës së parë dhe gjykata përmbarimore e shkallës së dytë kanë pasur për detyrë që të përmbarojnë vendimin e plotfuqishëm, të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm në pajtim me dispozitat e LPP-së, dhe jo të lëshohen në shqyrtimin e lartësisë së borxhit duke e përcaktuar për parashtruesen e kërkesës një epilog tjetër që dallon nga përmbajtja e Aktgjykimit të gjykatës kontestimore, që kërkohej të përmbarohet (Vendimit Res Judicata).
(...).”*

25. Në lidhje me ndryshimin e shumës së përgjithshme të përmbarimit parashtruesja e kërkesës thekson: *“gjykata e shkallës së dytë dhe gjykata e shkallës së parë si organe përmbarimore, e mbështesin në arsyetimin se debitori-B.M. ka përmbushur një pjesë të borxhit që e ka pasur për obligim që ta përmbushë në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1395/2015 i datës 02.10.2017, i ndryshuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.Nr.1302/2018 i datës 11.06.2018. Gjykata përmbarimore e shkallës së dytë ka theksuar se nga transkripta e transaksioneve e paraqitur nga debitori-B.M. shihet se i njëjti e ka përmbushur një pjesë të detyrimit që nga data 18.08.2015 deri me datën 04.07.2017.”*
26. Parashtruesja thekson se *“ne vazhdimësi ka theksuar dhe thekson se kontributi monetar nga debitori-B.M., për mbajtjen e femiut të mitur të palëve ndërgjyqëse daton para marrjes se aktgjykimeve, përmbarimin e të cilave e ka kërkuar kreditori. Parashtruesja e kërkesës thekson se kontributi periodik i debitorit për mbajtjen e femiut të mitur është bërë në periudhën kohore 18.08.2015 deri me datën 04.07.2017, ndërsa dy (2) aktgjykimet e përmbarimit, të cilave është kërkuar janë të datave 02.10.2017 dhe 11.06.2018. Prandaj, debitori nuk ka pasur mundësi të përmbush “detyrimin për alimentacion” para se ky detyrim të i caktohej nga gjykata kontestimore me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.Nr.1302/2018 i datës 11.06.2018, me të cilin është ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1395/2015 i datës 02.10.2017.”*
27. Parashtruesja e kërkesës tutje shton se *“provat që debitori-B.M. ka ofruar për të kontestuar lartësinë e borxhit janë jorelevante, ngase asnjëra prove nuk ndërlihet me shkaqet e prapësimit të përcaktuara taksativisht në nenin 71 të LPP-së. Siç është theksuar lart, kontributi periodik i debitorit-B.M., për mbajtjen e femiut të mitur është bërë në periudhën kohore 18.08.2015 deri me datën 04.07.2017, pra ky kontribut daton para datës kur ka lindur detyrimi mbi alimentacionin me vendimin e gjykatës kontestimore (Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ac.Nr.1302/2018 i datës 11.06.2018, me të cilin është*

ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1395/2015 i ditës 02.10.2017).”

28. Parashtruesja e kërkesës në lidhje me pretendimin e saj iu referohet disa rasteve të Gjykatës, dhe pretendon se të njëjtat janë të aplikueshme në rastin e saj. Në lidhje me këtë ajo thekson se:

“Gjykata Kushtetuese, në Aktgjykimin e saj në çështjen Vasilije Antovic (KI 25/18) kishte theksuar se "e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm nënkupton se një vendim i formës së prerë dhe detyrues (Res Judicata) duhet të konsiderohet si i pakthyeshëm". Njësoj, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në çështjen Brumarescu v. Rumanise, kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykim i 28 tetorit 1999, par. 61, thekson se "një nga aspektet themelore të shtetit ligjor është parimi i sigurisë juridike, i cili kërkon ndër të tjera se aty ku gjykatat kane vendosur përfundimisht një çështje, vendimi i tyre nuk duhet të vihet në pikëpyetje.

Në çështjet Ryabykh k. Rusise, nr. 52854/99, GJEDNJ, Aktgjykimi i 24 korrikut 2003, par. 52, dhe Soutransavto Holding kundër Ukrainës, kërkesa nr. 48553/99, paragrafi 72, GJEDNJ-ja thekson se "asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi të plotfuqishëm dhe detyrues gjyqësor thjesht për qëllimin e fitimit të rishqyrtimit dhe zgjidhjes së freskët të rastit". "Po të mos ishte kështu, kthimi prapa i vendimeve përfundimtare do të qonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë juridike, duke zvogëluar kështu besimin publik në sistemin gjyqësor", siç konstatoi Gjykata Kushtetuese në çështjen Rexhep Rahimaj (KI51/11), Aktgjykim i 2 korrikut 2012, par. 22. Çështjet e tjera që mund të i ndihmojnë gjykatës në zgjidhjen e kësaj çështjeje, e që i referohen parimit Res Judicata janë: K194/13, Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj, Aktgjykim i 14 prillit 2014; K155/n, Fatmir Pirreci, Aktgjykim i 16 korrikut 2012; KI132/15, Manastiri i Deçanit, Aktgjykim i 20majit 2016, KI150/16, Mark Frrok Gjokaj, Aktgjykim i 31 dhjetorit 2018; KI122/17.”

29. Në fund, parashtruesja e kërkesës nga Gjykata kërkon që ta shpallë kërkesën të pranueshme; të konstatojë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të Konventës; të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit [Ac.nr.4988/18], të 13 marsit 2019; dhe të njëjtin ta kthejë në rishqyrtim.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

32. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

[...]

“2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... .”

33. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar; ka shterur mjetet juridike në dispozicion; ka specifikuar aktin e autoritetit publik të cilin e konteston në Gjykatë, përkatësisht Aktvendimin [Ac.nr. 4988/18] e Gjykatës së Apelit, të 13 marsit 2019, dhe gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë kushtetuese të cilat ajo pretendon se i janë shkelur me aktin e kontestuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në kohë, në pajtim me nenin 49 të Ligjit.
34. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

35. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata verën se parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [Ac.nr. 4988/18] të 13 marsit 2019, me të cilin është vendosur në procedurë përmbarimore si e pabazuar ankesa e saj dhe ishin vërtetuar Aktvendimet e Gjykatës Themelore në Prizren, dega në Suharekë, të 1 dhe 17 tetorit 2018 për zvogëlimin e lartësisë së borxhit nga 5500 € (pesëmijë e pesëqind euro), në 4700 € (katërmijë e shtatëqind euro), përkatësisht në 2800 € (dymijë e tetëqind euro). Gjykata rikujton se shuma e përgjithshme e detyrimit në lartësinë prej 5500 € (pesëmijë e pesëqind euro) (objekti i përmbarimit), ishte përcaktuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [AC.nr.1302/2018] të 11 qershorit 2018, në procedurën kontestimore.
36. Në vazhdim, Gjykata rikujton se gjykatat e rregullta në procedurë kontestimore, vendosen fillimisht në lidhje me të drejtat dhe detyrimin civile, si në vijim: (i) për besimin dhe kujdesin e fëmijës O.M., dhe (ii) për përcaktimin e lartësisë mujore të alimentacionit (ushqimisë). Gjykata e Apelit me Aktgjykimin [AC. nr.1302/2018] e 11 qershorit 2018, kishte vërtetuar vendimin e shkallës së parë, sa i përket (i) besimit të fëmijës në kujdesje dhe edukim, dhe (ii) kishte ndryshuar vendimin e shkallës së parë sa i përket lartësisë mujore të detyrimit për alimentacionin, duk e ulur detyrimin mujor nga 200 € (dyqind euro), në 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro). Më këtë rast vendimi i Gjykatës së Apelit është përfundimtar.
37. Nga si me sipër, Gjykata verën se thelbi i pretendimeve të parashtrueses së kërkesës ka të bëjë me faktin se gjykatat përmbarimore kanë ndërhyrë në substancën e “çështjes së gjykuar” dhe me këtë rast kanë shkelur të drejtën e saj të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të Konventës. Në rrethanat e këtij rasti, Gjykata do të vlerësojë nëse pretendimi i parashtrueses së kërkesës, “*se me vendimet e gjykatave përmbarimore është prekur substanca e “gjësë së gjykuara” e cila garantohet me dispozitat e sipërcekura, është i bazuar.*
38. Në këtë drejtim, Gjykata, bazuar në esencën e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykimin të drejtë, rikujton përmbytjen nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6.1 të KEDNj-së, që përcaktojnë:

Neni 31 i Kushtetutës

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”

Neni 6. 1 i KEDNj-së

“1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.”

39. Në këtë aspekt, Gjykata thekson që çështjet përkitazi me vendimet e formës së prerë ose *res judicata* në kuptim, të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-se, janë interpretuar në mënyrë të hollësishme përmes praktikës gjyqësore të GJEDNj-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
40. Gjykata po ashtu vë në dukje se standardet dhe parimet e përcaktuara në praktiken gjyqësore të GJEDNj-së sa i përket respektimit apo shfuqizimit të një vendimi të formës së prerë, *res judicata*, tashme janë konfirmuar dhe vendosur edhe përmes vendimeve gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (shih, ndër të tjera, rastet, rasti nr. KI94/13, parashtrues: *Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj*, Aktgjykimi i 14 prillit 2014, rasti nr. KI132/15, *Manastiri i Deçanit*, Aktgjykimi i 20 majit 2016, rasti nr. KI150/16, parashtrues: *Mark Frrok Gjokaj*, Aktgjykim i 31 dhjetorit 2018).
41. Rrjedhimisht, në dritën e shqyrtimit të pretendimeve të parashtrueses së kërkesës për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, Gjykata fillimisht do t’i shtjellojë parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën e “sigurisë juridike” dhe të respektimit të një vendimi të formës së prerë “*res judicata*”, bazuar në standardet dhe parimet e përcaktuara në praktiken gjyqësore të vet Gjykatës dhe asaj të GJEDNj-së, të cilat në vijim do t’i aplikojë në rrethanat e rastit konkret.

Parimet e përgjithshme lidhur me sigurinë juridike dhe respektimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë (res judicata)

42. Gjykata, rikujton që e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm kërkon që një çështje që është bërë *res judicata* të konsiderohet e pakthyeshme, në pajtim me parimin e sigurisë juridike (shih rastin e GJEDNj-së, *Brumarescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykim i 28 tetorit 1999, paragrafi 61; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës KI 122/17, parashtrues: *Ceska Exportni Banka A.S.*, Aktgjykim i 30 prillit 2018, paragrafi 149, dhe rastin KI67/16, parashtruese: *Lumturije Voca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 janarit 2017, paragrafi 87).
43. GJEDNj, në lidhje me rëndësinë e respektimit të parimit të sigurisë juridike konstatoi se “një nga aspektet themelore të shtetit ligjor është parimi i sigurisë juridike, i cili kërkon ndër të tjera se aty ku gjykatat kanë vendosur

përfundimisht një çështje, vendimi i tyre nuk duhet të vihet në pikëpyetje" (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNj, *Brumarescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykim i 28 tetorit 1999, paragrafi 61, shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI89/13, parashtruese: *Arbresha Januzi*, Aktgjykim i 12 marsit 2014, paragrafi 83, KI122/17, parashtrues: *Ceska Exportni Banka A. S.*, Aktgjykim i 30 prillit 2018, paragrafi 149, rastin KI67/16, parashtruese: *Lumturije Voca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 janarit 2017, paragrafi 87, dhe rastin KI94/13, parashtrues: *Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj*, Aktgjykim i 14 prillit 2014).

44. Në lidhje me këtë, Gjykata verën se praktika e saj gjyqësore si dhe praktika gjyqësore e GJEDNj-së e përmendur me sipër, qartë dhe në mënyrë eksplicite, theksojnë se e drejta për gjykim të drejtë, sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së përfshin parimin e sigurisë juridike, i cili përfshin parimin që vendimet gjyqësore përfundimtare të cilat janë bërë *res judicata* duhet të respektohen dhe nuk mund të rihapen ose të bëhen objekt i ankesave.
45. Rrjedhimisht, në praktiken gjyqësore të Gjykatës dhe GJEDNj-së është theksuar se njeri nga aspektet themelore të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike, i cili presupozon *respektimin e vendimeve të formës së prerë, res judicata* (shih rastin *Brumarescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykimi i 28 tetorit 1999, paragrafi 62). Sipas GJEDNj-së “asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi të plotfuqishëm dhe detyruet gjyqësor thjesht për qëllim të fitimit të rishqyrtimit dhe zgjidhjes së freskët të rastit (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNj-së *Ryabykh kundër Rusisë*, nr. 52854/99, GJEDNJ, Aktgjykimi i 24 korrikut 2003, par. 52, dhe *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 48553/99, paragrafi 72; shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës, rastin nr. KI55/18, parashtrues *Fatmir Pirreci*, Gjykata Kushtetuese, Aktgjykimi i 16 korrikut 2012, par. 42 dhe rastin nr. KI94/13, parashtrues *Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj*, Aktgjykim i 14 prillit 2014).

Zbatimi i parimeve të lartpërmendura në rrethanat e rastit konkret

46. Në këtë drejtim, në rastin e parashtrueses së kërkesës Gjykata do të vlerësojë nëse me Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit [Ac.nr. 4988/18] të 13 marsit 2019, me të cilin ishin vërtetuar Aktvendimet e Gjykatës Themelore në Prizren, dega në Suharekë, të 1 dhe 17 tetorit 2018, me të cilët ishte zvogëluar shumica e përgjithshme e përmbarimit (i) është cenuar parimi i “çështjes së gjykuar” siç është vendosur në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [AC. nr.1302/2018] të 11 qershorit 2018; nëse (ii) është vënë në pikëpyetje çështja e vendosur përfundimisht me Aktgjykimi e Gjykatës së Apelit [AC. nr.1302/2018] të 11 qershorit 2018, dhe nëse (iii) vendimi gjyqësor përfundimtar në procedurën kontestimore, përkatësisht Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit [AC. nr.1302/2018] i 11 qershorit 2018, i cili është bërë *res judicata*, ishte rihapur me Aktgjykimin e kontestuar, në procedurë përmbarimore.
47. Në lidhje me këto kritere, Gjykata i referohet pjesëve relevante të Aktvendimit [Cp.nr.82/2018] të Gjykatës Themelore në Prizren, dega në Suharekë, të 1 tetorit 2018, në procedurën përmbarimore, më të cilin u ndryshua fillimisht shumica e përgjithshme e detyrimit, për të cilën parashtruesja e kërkesës

pretendon se një ndërhyrje e tillë prekë substancën e “çështjes së gjykuar” të vendosur në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [AC.nr.1302/2018], të 11 qershorit 2018. Gjykata në fjalë, përmes Aktvendimit në fjalë, kishte arsyetuar:

“...në arsyetimin e prapësimit të ushtruar pranë kësaj Gjykate, kundër Aktvendimit Cp.nr.82/2018, dt. 28.08.2018, është thirrur në atë se debitori ka përmbushur një pjesë të lartësisë së borxhit që e ka pasur për obligim që ta përmbush në bazë të aktgjykimeve, këtij fakti i njëjti i ka suportuar edhe provën mbi transaksionet - pagesat e bëra në llogarinë bankare të kreditorit në ProCreditBank dhe atë: Më 18.08.2015, duke përmbushur obligimin për 3 muaj qershor, korrik, gusht në shumen prej 350.00€, Me dt. 22-23.09.2015, duke përmbushur obligimin për muajin shtator 2015, në shumën prej 100.00€; Më dt. 06.12.2015, duke përmbushur obligimin në shumë prej 100.00€; Më dt. 05.04.2017, duke përmbushur obligimin në shumë prej 100.00€; Me dt. 17.04.2017 - 28.04.2017, një pagese (dhuratë për O.M) në shumë prej 20.00€; Me dt. 07.05.2017-08.05.2017, duke përmbushur obligimin në shumë prej 100.00€; me dt. 04.07.2017, duke përmbushur obligimin në shumë prej 100.00€. Gjyqtari këtë prove të proceduar nga i autorizuari i debitorit, e vlerësoj deri në shumen prej 850.00€ dhe jo në shumën e paraqitur si në arsyetimin e prapësimit të debitorit në vlerë prej 2,750.00€. Arsyetimin e këtij vlerësimi gjykata e mbështet në faktin se, nga data e paraqitjes së padisë me 16.06.2015, e deri me dt. 31.07.2018, është akumuluar shuma e paraqitur si në propozimin përmbarimor nga kreditorja, mirëpo nga transkripta e transaksioneve të paraqitur nga debitori shihet se i njëjti e ka përmbushur një pjesë të detyrimit, qysh nga data. 18.08.2015, e gjer me dt. 04.07.2017 dhe, kështu një përmbarim të tillë kundrejt kësaj shume do të shkaktonte begatim pa shkak për kreditorin.”

48. Gjykata po ashtu i referohet pjesëve relevante të Aktvendimit [Cp.nr.82/2018] të Gjykatës Themelore në Prizren, dega në Suharekë, të 17 tetorit 2018, përmes së cilit gjykata në fjalë e korrigjoi Aktvendimin e vet, të 1 tetorit 2019, përkitazi me shumën e përgjithshme të detyrimit, duke arsyetuar:

“Andaj, pasi që gjykata shikoj edhe një herë transaksionin e pagesave për debitorin, lidhur me kreditë, e njëjta vërtetoj faktin se debitori ka përmbushur një pjesë të detyrimit lidhur me alimentacionin dhe atë, si në vijim: për dt. 08.08.2015 debitori ka paguar shumën prej 350 €, për dt. 22.09.2015 shumën prej 100€, për dt. 02.11.2015 shumën n prej 100€, për datën e njëjtë shumën prej 100€, për dt. 03.01.2016 shumën prej 100€, për datën 07.02.2016 shumën prej 100€, për datën 07.03.2016 shumën prej 100€, për datën 02.04.2016 shumën prej 100€, për datën 03.05.2016 shumën prej 100€, për datën 09.05.2016, shumën prej 150€, për datën 05.07.2016, shumën prej 100€, për datën 31.07.2016, shumën prej 100€, për datën 03.09.2016 shumën prej 150€, për datën 02.10.2016 shumën prej 150€, për datën 02.11.2016 shumën prej 100€, për datën 01.12.2016 shumën prej 100€, par datën 05.01.2017 shumën prej 100€, për datën 04.03.2017 shumën prej 100€, për datën 05.04.2017 shumën prej 100€, për datën 08.05.2017 shumën prej 100€, për datën 01.06.2017 shumën prej 150€, për datën 04.07.2017 shumën prej 100€, nga e gjithë kjo shuma totale prej 2750,00€.”

49. Më tej, Gjykata verën se Gjykata e Apelit, me Aktvendimin e kontestuar, [Ac.nr.4988/18], e kishte lënë në fuqi aktvendimin e shkallës së parë, të 17 tetorit 2018, duke arsyetuar se:

“Zbatimi i ligjit material në këtë çështje kontestuese, përveç se është zbatuar drejtë sa i përket detyrimit të debitorit për inkasimin e mjeteve të alimentacionit, në raport me kreditoren i njëjti është zbatuar drejtë edhe sa i përket lartësisë.

Konform dispozitës së dispozitës së nenit 165 par.1 të LPK-se, “Gabimet në emra dhe numra, si dhe gabimet tjera në shkrim dhe llogaritje, mangësitë në aspektin e formës së aktgjykimit dhe mospajtimi i kopjes me origjinalin e aktgjykimit i korrigjon gjykata në çdo kohë.

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin Cp.nr.82/18 të datës 17.10.2018, e ka pranuar se ka bërë gabim në llogaritje të pagesave të alimentacionit, prandaj me të drejtë ka korrigjuar aktvendimin CP.nr.82/18 të datës 01.10.2018 sa i përket shumës prej 4.700.00 euro ku duhet të jetë shuma prej 2. 800 euro, dhe këtë pjesë të diapozitivit e korrespondon me pjesën e arsyetimit.”

50. Gjykata, bazuar nga si me sipër, verën se gjykatat përmbarimore në të vërtetë nuk kanë prekur substancën e “çështjes së gjykuar” dhe nuk kanë venë në pikëpyetje çështjen e vendosur përfundimisht, ashtu siç ka përcaktuar Gjykata e Apelit me vendimin përfundimtar [AC. nr.1302/2018] të 11 qershorit 2018.
51. Në fakt, Gjykata vë në pah se gjykata përmbarimore e shkallës së parë, me Aktvendimin [Cp.nr.82/2018], të 17 tetorit 2018, vlerësoi se shumës së përgjithshme të detyrimit prej 5500 € (pesëmijë e pesëqind euro), duhet t'i zbriten 2750 € (dymijë e shtatëqind e pesëdhjetë euro), sepse u vërtetua se një pjesë e detyrimit, në emër të alimentacionit ishte përmbushur nga ish-bashkëshorti i parashtrueses së kërkesës, nëpërmjet transaksioneve bankare, përfshi periudhën kohore, 8 gusht 2015 - 4 korrik 2017. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se gjykatat përmbarimore nuk kanë prekur substancën e asaj që ishte vendosur, sipas procedurës kontestimore, me Aktgjykimin përfundimtar [AC.nr.1302/2018] të Gjykatës së Apelit, të 11 qershorit 2018, sepse gjykatat përmbarimore nuk kanë rihapur ose ndryshuar çështjet e gjykuar, as sa i përket: i) besimit, kujdesit dhe edukimit të fëmijës O.M. dhe as sa i përket ii) përcaktimit të lartësisë së detyrimit mujor prej 150€ (njëqind e pesëdhjetë euro), në lidhje me alimentacionin, por kanë korrigjuar shumën e përgjithshme të detyrimit prej 5500€ (pesëmijë e pesëqind euro), nga arsyet e shtjelluara me lartë në paragrafët 47 dhe 48 të këtij vendimi.
52. Sa i përket pretendimit të parashtrueses së kërkesës se gjykatat përmbarimore është dashur t'i marrin parasysh parashtrësat e dorëzuara nga palët ndërgjyqëse, Gjykata vlerëson se nuk është në juridiksionin e saj, si Gjykatë të përcaktojë nëse gjykatat përmbarimore është dashur t'i marrin parasysh parashtrësat e dorëzuara nga palët ndërgjyqëse, ose të vlerësojë nëse ato kanë interpretuar ose zbatuar gabimisht ligjin procedural dhe material. Në të vërtetë, një pretendim i tillë, sipas vlerësimit të Gjykatës bie në kategorinë e pretendimeve të cilat ngrenë çështje të faktit dhe të ligjit (ligjshmërisë), të cilat

si rregull janë kompetencë e gjykatave të rregullta, për aq sa vendimmarrja e tyre të mos çojë në arbitraritet të dukshëm.

53. Në këtë vazhdë, Gjykata përsëritë se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafi 28).
54. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës, KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
55. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës së rregullt, në këtë rast asaj përmbartimore. Megjithatë, pakënaqësia e saj me rezultatin e procedurës se ndjekur në gjykatat e rregullta, nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21, dhe shih, gjithashtu, rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
56. Për më tepër, parashtruesja e kërkesës në lidhje me pretendimin për shkelje të të drejtave të saj i referohet disa rasteve të kesaj Gjykate dhe të GJEDNJ-së, dhe pretendon se këto të njëjtat janë të aplikueshme në rastin e saj. Megjithatë përderisa gjykata, si me sipër, vlerësoi se në rastin konkret nuk është cenuar substanca e “gjësë së gjykuar” e cila garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës, rastet e referuara nuk mund të gjejnë zbatim në rastin konkret. Andaj, nga si me sipër, Gjykata konsideron se rastet të cilave parashtruesja e kërkesës u është referuar, si me sipër, ndryshojnë për nga rrethanat faktike dhe juridike të rastit konkret.

Përfundim

57. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës, në baza kushtetuese, nuk i ka mbështetur pretendimet e saj se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me Aktvendimin e kontestuar i janë shkelur asaj të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me Konventë (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
58. Rrjedhimisht, Gjykata, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës konkludon se kërkesa e parashtrueses, në baza kushtetuese, duhet të shpallet e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 13 maj 2020, njëzëri


VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi

